



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.5, 15.1 (c) dhe 21.2 të Ligjit Nr.03/L-051 për Aviacionin Civil

Duke pasur parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (më tej referuar si “Marrëveshja për HPEA”) në emër të Kosovës, nga ana e UNMIK-ut, si dhe hyrjes së përkohshme në fuqi të Marrëveshjes për HPEA, për Kosovën, më 10 tetor 2006,

Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës ka pranuar obligimet ndërkombëtare të Kosovës përfshirë edhe ato të lidhura në emër të Kosovës nga UNMIK-u,

Duke pasur parasysh obligimin nga Marrëveshja për HPEA, që kërkesat e përbashkëta të aviacionit (JAR) të miratuara nga Autoritetet e Përbashkëta të Aviacionit, të jenë pjesë e rendit të brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE NR. 3/2010
E AUTORITETEVE TË PËRBASHKËTA TË AVIACIONIT (JAR) MBI
KËRKESAT DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE TË APLIKUESHME NË
TRANSPORTIN KOMERCIJAL AJROR - HELIKOPTERËT**

*Neni 1
Zbatueshmëria*

Kjo Rregullore përcakton kushtet dhe procedurat administrative të aplikueshme për operimin e çdo helikopteri civil që aplikon transport komercial ajror, si dhe mënyrën e operimit të helikopterit dhe personave e organizatave të përfshira në këto detyra.

*Neni 2
Përkufizimet*

Për qëllim të kësaj Rregulloreje përdoren përkufizimet në vazhdim:

Certifikata e Operatorit Ajror (AOC) - një dokument i lëshuar nga Autoriteti që konfirmon se operatori ajror është në përputhje me kërkesat e parashikuara për kryerjen e veprimtarisë së transportit komercial ajror të përcaktuar në certifikatë,

Autoriteti - nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AACK),

Operimet Komerciale - operim i avionit që përfshin transportin e udhëtarëve, mallrave ose postës me kompensim ose me qira, apo operimet e kryera në përputhje me kontratën e lidhur ndërmjet operatorit të aeroplanit dhe përdoruesit të shërbimit, ku përdoruesi nuk ka kontroll mbi operatorin e aeroplanit,

Kërkesat e Përbashkëta të Aviacionit (JAR) - rregullore të aviacionit të lëshuara nga Autoritetet e Përbashkëta të Aviacionit (JAA),

Neni 3 Njohja e Aprovimeve

Autorizimet, miratimet dhe certifikatat, të lëshuara në përputhje me kërkesat e përbashkëta teknike dhe procedurat administrative të specifikuara në Kërkesat e Përbashkëta të Aviacionit JAR-OPS 3 - Transporti Komercial Ajror - (Helikopterët) - Amendamenti 5, datë 1 korrik 2007, nga Anëtarët dhe Partnerët e HPEA (ECAA), do të njihen nga Autoriteti, pa kërkesa teknike ose vlerësim shtesë.

Neni 4 Referenca në Rregullore tjera

Dispozitat e Pjesës 1, Nën pjesa M e JAR-OPS 3 - Transporti Komercial Ajror - Helikopterët, duke iu referuar vlefshmërisë ajrore të vazhdueshme të helikopterëve dhe dispozitave të Aneksit 1, Pjesa M e Rregullores së Komisionit (EC) Nr 2042/2003 datë 20 nëntor 2003, mbi vlefshmërinë ajrore të vazhdueshme të avionëve dhe prodhimeve aeronautike, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për aprovimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra, duke zbatuar çdo amendamentim dhe/ose plotësim.

Neni 5 Kërkesat e Përbashkëta të Aviacionit (JAR) të zbatueshme

5.1 Përveç përputhjes me dispozitat e kësaj Rregulloreje, një operator ajror duhet të jetë në përputhje me kërkesat përkatëse të Kërkesave të Përbashkëta të Aviacionit (JAR) të cilat janë të lidhura me veprimet e tyre në renditjen e mëposhtme:

1. JAR-1 Përkufizimit dhe Shkurtesat;
2. JAR-26 Kërkesa shtesë të vlefshmërisë ajrore për Operacionet;

3. JAR-STD 1H Simulatorët e Fluturimit për Helikopterë;
4. JAR-STD 2H Pajisjet e Trajnimit për Fluturimim me Helikopterë;
5. JAR-STD 3H Procedurat e Fluturimit dhe Navigimit për Helikopterë për Trajnuesit;
6. JAR-FSTD H Pajisjet Simuluese Trajnuese të Fluturimit për Helikopterë;
7. JAR-MMEL/MEL Lista e pajisjeve minimale master/Lista e pajisjeve minimale;

5.2 Materiali Udhëzues i Pranueshëm (AMC)/Materiali Interpretues dhe Shpjegues (IEM) në Pjesën 2 të JAR-OPS 3, do të zbatohen deri sa të publikohen udhëzime tjera që e rregullojnë këtë fushë.

*Neni 6
Interpretimi*

Në rast të ndryshimit të varianteve të përkthyer të JAR-OPS 3 (Amendamenti 5) në gjuhët shqipe dhe/apo serbe me variantin origjinal në gjuhën angleze, varianti në gjuhën angleze i JAR-OPS 3 Amendamenti 5, i cili i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje, do të ketë përparësi.

Neni 7

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 10 tetor 2010.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm